



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 janar 2011
Nr. ref.: RK 80/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 11/10

Parashtruesi

Feti Islami

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev.395/2008 dhe vendimit të Gjykatës së Qarkut në Komunën e Pejës
Ac.Nr.306/06**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Feti Islami nga Peja.

Vendimet e kontestuara

2. Vendimet e kontestuara janë: vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev. 395/2008 i datës 2. 6. 2009 dhe vendimi i Gjykatës së Qarkut në Komunën e Pejës Ac. Nr. 306/06 i datës 25. 5. 2008.

Objekti i çështjes

3. Subjekt i lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 26. 01. 2010 është vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës rev. 395/2008 me të cilin është refuzuar revizioni i paditësve: Feti Islami, Zyhdi Islami, Nexhmedin Islami, Belkize Shala, Muhamet Islami, Sehid Islami dhe Myzafere Dobroshti i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 306/06 dhe i vetë aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac .nr. 3006/06 me të cilin është refuzuar ankesa e të të njëjtëve paditës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë C. nr 195/05. i datës 26. 05. 2006 .

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese

4. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me vendimet e sfiduara të gjykatave kompetente i janë shkelur e drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës si në vijim:
 - a) Të drejtat dhe liritë themelore sipas nenit 21 par. 1,2,3 dhe 4;
 - b) Shkeljet e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare sipas nenit 22 par. 1,2,3 dhe par. 4;
 - c) Shkeljet e mos barazisë para ligjit sipas nenit 24 par. 1. 2 dhe 3;
 - d) Shkeljet për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 par. 1;
 - e) Shkeljet për mos transparencë dhe pengesat në të drejtën për qasje në dokumente publike, neni 41 par 1 dhe 2;
 - f) Shkeljet e të drejtës për mbrojtje të pronës sipas nenit 46 par. 1 dhe 3;
 - g) Shkeljet në interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane, neni 53; dhe
 - h) Shkeljet e të drejtës në mjete efektive ligjore sipas nenit 54.

Baza juridike

5. Neni 113. 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejme - Ligji) dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese me 26 janar 2010.
7. Më 25 mars 2010, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruar nga z. Feti Islami dhe më 26. 03. 2010 Gjykata Supreme e Kosovës me shkresën Agj. nr. 147/2010 i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës përgjigje në parashtrësën e saj lidhur me kërkesën KI 11/10, dhe me atë rast ka theksuar se "Gjykata Supreme të gjitha faktet që kanë të bëjnë me rastin i ka dhënë në arsyetimin e Aktgjykimit Rev. nr. 395/08 dhe se nuk ka çka të shtojë më shumë për këtë rast".
8. Më 31 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese i dërgoi shkresë Gjykatës Komunale në Pejë dhe kërkoi nga kjo gjykatë aktgjykimin AC. nr. 54/01 të datës 30. 3. 2001, që mungonte në

shkresat e lëndës së parashtruar para saj, dhe nga kjo gjykatë mori kopjen e kërkuar të aktgjykimit me 16.09.2010.

9. Më 13 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Robert Carolan dhe Enver Hasani, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Ankesa e parashtruesit

10. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Gjykata e Qarkut me aktgjykimin Ac. nr. 306/06, me të cilin refuzoi padinë e paditësve të përmendur më sipër dhe gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar revizionin lidhur me këtë aktgjykim, kanë shkelur të drejtën për vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë në qytetin e Pejës, e që në Shërbimin Komunal të Kadastrës evidentohet si pronë shoqërore. Ankuesi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që në përputhje me nenin 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës –të kthejë gjendjen e mëparshme para aktgjykimeve për lejimin e përsëritjes së procedurës dhe lënien në fuqi të aktgjykimit të Gjykatës komunale të Pejës C. nr. 54/01 të datës 28. 03. 2001 i cili ishte i favorshëm për parashtruesin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 30. 03. 2001, Gjykata Komunale në Pejë ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 54/01, me të cilin ka aprovuar padinë e paditësve Feti Islami, Zyhdë Islami, Nexhmedin Islami, Belkize Shala, Muhamet Islami, Shahid Islami dhe Myzaferë Dobroshi dhe ua ka njohur të drejtën e pronës në paluajtshmërinë e evidentuar në ngastrat kadastrale 2774, në sipërfaqe prej 3007, 3021, 2976 ar të cilat evidentohen në fletat poseduese 2606 dhe 313 KK-Pejë, dhe atë: dy paditësve të parë - Feti dhe Nexhmedin Islami, secilit në madhësinë prej 5/20 pjesë ideale, ndërsa paditësve tjerë Belkize, Muhamet, Zuhdi, Sahit dhe Muzaferë, secilit nga 2/20 pjesë ideale.
12. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm më 28. 06. 2001.
13. Komuna e Pejës, në cilësinë e të paditurës, kishte bërë kërkesë për lejimin e përsëritjes së procedurës dhe Gjykata Komunale e Pejës, më 11. 04. 2003, me Aktvendimin C. nr. 54/01 ka APROVUAR propozimin dhe ka LEJUAR përsëritjen e procedurës.
14. Sipas ankesës së palëve paditëse, kundër këtij aktvendimi Gjykata e Qarkut e Pejës ka nxjerrë aktvendimin AC. nr. 262/03 të datës 25. 05. 2004, me të cilin PRISHET aktvendimi i Gjykatës Komunale në Pejë C. nr. 54/01, me të cilin ishte lejuar përsëritja e procedurës dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në Rigjykim.
15. Më 04. 11. 2004, Gjykata Komunale në Pejë duke vendosur përsëri sipas urdhëresës së Gjykatës së Qarkut, në procedurën e rigjykimit të rastit PËRSËRI ka vendosur që të APROVOJË propozimin e të paditurës - Komuna e Pejës dhe ka lejuar përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm në Gjykatën Komunale në Pejë, e me të cilin paditësve të sipërpërmendur në pikën 6 të këtij raporti iu është aprovuar padia për njohjen e të drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë që ishte objekt padie, ose kundërvlera në shumë prej 114.000 €.
16. Më 26. 05. 2006, Gjykata Komunale në Pejë duke vepruar sipas kërkesëpadisë së paditësve Feti Islami, Zyhdë Islami, Nexhmedin Islami, Belkize Shala, Muhamet Islami, Shahid Islami dhe Myzaferë Dobroshi, tashmë sipas procedurës së përsëritur të lejuar, ka nxjerrë AKTGJYKIMIN C. nr. 195/05 me të cilin ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke vlerësuar se paditësit nuk kanë ofruar prova me të cilat

do të vërtetonin të drejtën në pronësi në paluajtshmërinë e kontestuar, ndërsa pala e paditur - Komuna e Pejës kishte vërtetuar me prova bindëse se prona që është objekt padie është pronë shoqërore dhe se ish-pronarët ishin kompensuar me rastin e ekspropriimit të saj në mënyrë ligjore.

17. Më 22. 05. 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin Ac .nr. 306/06 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve të parashtruar nëpërmjet të autorizuarit të tyre dhe ka VËRTETUAR aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë C. nr. 195/05 të datës 26. 05. 2006.
18. Më 02. 06. 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 395/2008, ka refuzuar si të PABAZUAR revizionin e paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 306/2006.
19. Këtë aktgjykim, z. Feti Islami sipas pohimit të tij personal, të shkruar në kopjen e tij, e ka pranuar më 15. 07. 2009.
20. Z. Feti Islami i pakënaqur me rrjedhën e lëndës, ka paraqitur parashtresë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor kundër gjyqtarit Ymer Jahëmurataj, pastaj gjithashtu, kundër të njëjtit gjyqtar ka paraqitur edhe kallëzim penal PP.nr. 1915-15/09 i cili është refuzuar pjesërisht dhe pala është udhëzuar të ngrejë padi private, nëse akoma mendon se ka bazë për ndjekje penale.
21. Z. Feti Islami ka paraqitur edhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit e cila është regjistruar me PCK. nr. 108/09, dhe nga kjo Prokurori ka marrë përgjigjeje se kundër vendimeve të Gjykatës Supreme për revizion nuk mund të iniciohet procedura për mbrojtje të ligjshmërisë.
22. Përfundimisht, më 26. 01. 2010, z. Feti Islami ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë

23. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Neni 47.2 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës përcakton:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

26. Neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton se:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

27. Nga dokumentacioni i paraqitur prej parashtruesit të kërkesës, konstatohet se z. Feti Islami kërkesën e ka paraqitur në Gj. Kushtetuese më 26. 01. 2010 ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Supreme, si vendim të fundit, e ka pranuar më 15. 07. 2009 dhe nga ky fakt del se ai kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e ka dorëzuar pasi që kanë kaluar 6 muaj e 11 ditë nga dita e pranimit të vendimit të fundit, dhe duke iu referuar kriterëve të pranueshmërisë, del se kjo kërkesë është e papranueshme sepse është paraqitur në Gjykatë pas kalimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
28. Gjykata konstaton se edhe sikur kërkesa të ishte paraqitur brenda afatit të paraparë prej 4 muajsh, ajo prapë se prapë do të duhej të deklarohej si e papranueshme sepse është haptazi e pabazuar.
29. Në të vërtete, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk e gëzon juridiksionin e apelit dhe nuk mund të ndërhyjë nga aspekti teorik nëse këto gjykata kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "Gjykatë e shkallës së katërt", (shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
30. Për më tepër, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjykatave të rregullta gjatë dëgjimeve të rastit, iu mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk u jep atyre të drejtën që mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih mutatis mutandis aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aktgjykim i 26 korrikut 2005).
31. Meqenëse me nenin 53 të Kushtetutës është paraparë që "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", ndërsa sipas nenit 22 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokolleve të sajë zbatohet drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, atëherë sikur që GJEDNJ e deklaroi, sipas nenit 35.3 të saj, një kërkesë të papranueshme sepse është haptazi e pabazuar në raport me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih mutatis mutandis Application no. 25101/05 by Mordechai Poznanski and Others against Germany) edhe Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën si të papranueshme, si haptazi të pabazuar në raport me Kushtetutën e Kosovës kur deklarohet për pranueshmërinë e saj (neni 54 par .1 pika (b) e Rregullores së punës së Gj. Kushtetuese.)
32. Në këto rrethana, parashtruesi nuk i ka plotësuar kriteret për lejueshmërinë e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe dëshmive të ofruara dhe pas shqyrtimit të çështjes më 13 dhjetor 2010, përfundoi se parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën pas kalimit të afatit 4 mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe njëzëri,

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;


Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani